

NJOFTIM PËR VEND PUNE

A- Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreut IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenit 22 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se:

Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin: **“specialist”, në Sektorin e Projekteve, pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm.**

a) Paga është e kategorisë IV, klasa III-3.

Qëllimet e pozicionit të punës:

- Të kontribuojë në planifikimin dhe zbatimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme të projekteve dhe programeve të financuara nga donatorë të huaj, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Kuvendit.
- Të ofrojë një shërbim me standart të lartë e profesionalizëm ndaj partnereve të huaj gjatë procesit të programimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkta, në të cilat Kuvendi është përfitues, me qëllim përfitimin maksimal nga asistenca e huaj.

b) Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të identifikojë, në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Kuvendit, nevojat e Kuvendit për asistencë teknike dhe financiare nga programe dhe projekte të ndryshme.
- Të bashkërendojë punën e Shërbimeve të Kuvendit gjatë procesit të programimit dhe zbatimit të projekteve, në të cilat Kuvendi i Shqipërisë është institucion përfitues.
- Të sigurojë programimin në kohë të projekteve, duke kryer analiza sektoriale, identifikuar projekte, përgatitur fishat e projekteve si dhe duke përgatitur termat e references për ekspertët të cilët do të kryejnë procesin e vlerësimit të nevojave të Kuvendit për asistencë të huaj.
- Të koordinojë programimin, zbatimin dhe monitorimin e kontratave të projekteve, ku Kuvendi i Shqipërisë është institucion përfitues, në kuadër të asistencës financiare që Bashkimi Europian i akordon Kuvendit.
- Të veprojë si pikë kontakti ndërmjet Kuvendit dhe autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).

- Të mbajë lidhje të ngushta me donatorët e huaj në kuadrin e përfitimit të projekteve dhe programeve të reja.
- Të raportojë mbi ecurinë dhe zhvillimin e projekteve të Sekretarit të Përgjithshëm.
- Të kryej detyra të tjera të ngakuara nga Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me zyrën e projekteve

Marrëdhëniet organizative

Specialisti i projekteve është nën varësinë direkt të Sekretarit të Përgjithshëm. Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij/saj, specialisti për projektet bashkëpunon me punonjësit e tjerë të zyrës së sekretarit të Përgjithshëm, si dhe me drejtuesit e shërbimeve të administratës së Kuvendit.

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda të njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë.”
- të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

- Të ketë diplomë universitare DND; DIND ose Bachelor + Master shkencor/ profesional
- Të ketë eksperience pune;
- Të ketë aftësi shumë të mira të komunikimit verbal dhe me shkrim.
- Të ketë aftësi të orientohej me efektivitet në situata komplekse dhe nën tryninë e kohës.
- Të zotërojë shumë mirë me shkrim dhe me gojë gjuhën angleze.

c) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia Përgjegjëse), këto dokumente: letër motivimi për aplikim në vendin vakant; një kopje të jetëshkrimit (C.V.), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar, një fotokopje e librezës së punës e plotësuar, vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit, vendimi i konfirmimit si nëpunës civil i kategorisë ekzekutive dhe formularin e gjashtëmujorit të parë të vlerësimit vjetor të punës.

d) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në **datën 14.10.2024.**

dh) Në datën 15.10.2024, do të shpallet lista e vlerësimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin (në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë ata që plotësojnë kushtet minimale të lëvizjes paralele dhe kushtet e veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda **3** ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

-Konkurrimi- intervista me gojë do të zhvillohen **në datën 24.10.2024**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10:00**.

ë) Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

f) Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele”, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. **Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 40 pikë për dokumentacionin dhe 60 pikë për intervistën e strukturuar me gojë** (dokumentacioni i dorëzuar, i ndarë: 20 pikë për eksperiencën, 10 pikë për trajnimet apo për kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse dhe 10 pikë për vlerësimet pozitive.)

g) Njoftimi për fituesin do të bëhet në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit në **datën 31.10.2024**.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni +35542278270 dhe +35542278425 ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet, pjesë e shërbimit civil.

Nëse nuk ka një fitues, nga procedura e lëvizjes paralele, konkurrimi do të vazhdojë sipas Kreu IV–“Pranimi në shërbimin civil”, të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar , nenit 22 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Kreu II “Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive”.

B- Pranimi në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kreut IV , “Pranimi në shërbimin civil”, nenit 22 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë

18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, njofton se;

Në Administratën e tij ka 1 (një) vend të lirë pune, në pozicionin: **“specialist”, në Sektorin e Projekteve, pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm**

a) Paga është e kategorisë IV, klasa III-3.

Qëllimet e pozicionit të punës:

- Të kontribuojë në planifikimin dhe zbatimin në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme të projekteve dhe programeve të financuara nga donatorë të huaj, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së Kuvendit.
- Të ofrojë një shërbim me standart të lartë e profesionalizëm ndaj partnereve të huaj gjatë procesit të programimit dhe zbatimit të projekteve të përbashkta, në të cilat Kuvendi është përfitues, me qëllim përfitimin maksimal nga asistenca e huaj.

c) Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Të identifikojë, në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Kuvendit, nevojat e Kuvendit për asistencë teknike dhe financiare nga programe dhe projekte të ndryshme.
- Të bashkërendojë punën e Shërbimeve të Kuvendit gjatë procesit të programimit dhe zbatimit të projekteve, në të cilat Kuvendi i Shqipërisë është institucion përfitues.
- Të sigurojë programimin në kohë të projekteve, duke kryer analiza sektoriale, identifikuar projekte, përgatitur fishat e projekteve si dhe duke përgatitur termat e references për ekspertët të cilët do të kryejnë procesin e vlerësimit të nevojave të Kuvendit për asistencë të huaj.
- Të koordinojë programimin, zbatimin dhe monitorimin e kontratave të projekteve, ku Kuvendi i Shqipërisë është institucion përfitues, në kuadër të asistencës financiare që Bashkimi Europian i akordon Kuvendit.
- Të veprojë si pikë kontakti ndërmjet Kuvendit dhe autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit të decentralizuar të asistencës së Bashkimit Europian, në kuadër të Instrumentit të Parazgjerimit (IPA).
- Të mbajë lidhje të ngushta me donatorët e huaj në kuadrin e përfitimit të projekteve dhe programeve të reja.
- Të raportojë mbi ecurinë dhe zhvillimin e projekteve të Sekretarit të Përgjithshëm.
- Të kryej detyra të tjera të ngakuara nga Sekretari i Përgjithshëm në lidhje me zyrën e projekteve

Marrëdhëniet organizative

Specialisti i projekteve është nën varësinë direkt të Sekretarit të Përgjithshëm. Për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij/saj, specialisti për projektet bashkëpunon me punonjësit e tjerë të zyrës së sekretarit të Përgjithshëm, si dhe me drejtuesit e shërbimeve të administratës së Kuvendit.

Kërkesat e përgjithshme për këtë vend pune janë:

- Të jetë shtetas shqiptar
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë:

- Të ketë diplomë universitare DND; DIND ose Bachelor + Master shkencor/ profesional
- Të ketë eksperience pune;
- Të ketë aftësi shume te mira te komunikimit verbal dhe me shkrim.
- Të ketë aftësi të orientohe me efektivitet ne situata komplekse dhe nën trysinë e kohës.
- Të zotërojë shumë mirë me shkrim dhe me gojë gjuhën angleze.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Shërbimin e Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve të Kuvendit (Njësia Përgjegjëse), këto dokumenta; letër motivimi për aplikim në vendin vakant; një kopje të jetëshkrimit (C.V), fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehësuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, fotokopje e listës së notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash, të ndryshme me vlerësimin e njohur në shtetin shqiptar, atëhere aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar; një fotokopje e librezës së punës e plotësuar; vërtetim i gjendjes gjyqësore, certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme, fotokopje e letërnjoftimit.

ë) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në **datën 19.10.2024**.

f) Në datën **01.11.2024**, do të shpallet lista e vlerësimit të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut. Këta do të jenë ata që plotësojnë të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të kërkuara më sipër.

-Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

g) Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët do të jetë nëpërmjet njoftimeve në Portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, faqen zyrtare të Kuvendit, telefon dhe e-mail.

gj) Konkurrimi-**testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë** do të zhvillohen në **datën 12.11.2024**, në mjediset e Kuvendit, në orën **10-00**.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për specialitetin, Kushtetutën, ligjin “Për nëpunësin civil”, Kodin e Procedurave Administrative si dhe të legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Kuvendit.

h) Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. **Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100**, të cilat ndahen përkatësisht: vlerësimi i jetëshkrimit - **15 pikë**, intervista e strukturuar me gojë - **25 pikë** dhe testimi me shkrim - **60 pikë**.

i) Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi 70% të pikëve) do t’u njoftohet kandidatëve me telefon ose e-mail.

j) Ankesat nga kandidatët fitues, paraqiten në Komitetin e Përhershëm të Pranimit, brenda 5 ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

k) Shpallja e listës përfundimtare të fituesve do të bëhet në **datën 19.11.2024**, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Kuvendit dhe në stendën e informimit të publikut.

Për sqarime, mund të kontaktoni me numër telefoni +35542278270 dhe +35542278425 ose në adresën: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.4, Tiranë.